

“ Dhjetori - Muaji i Pyjeve”

NJË DITE, NË PYJET E DUMRESË

Gjon Fierza,
specialist ne MMPAU

Muaji dhjetor, thuhet tashme se 40 vjet, cilesohet si Muaji i Pyjeve ne Shqiperi. Kjo ka sherbyer, i ka nxitur njerezit, pushtetaret, te gjitha dashamiresit e natyres te shtojne me teper perkujdesjen dhe veprimtarine per pyjet si nje pasuri e pazevendesueshme. Pyjet gjithnje e me teper po marrin nje rol te vecante te lidhur me vete ekzistences e jetes ne toke. Nga komunitetit i pylltareve dhe jo vetem prej tyre kerkohet; harmonizim i nevojave te njerzeve dhe te planetit per pyje, keshtu bota mund te perparojë ne rrogen e qendrueshmerise dhe zhvillimit.

Per pyjet ndoshta duhet menduar e punuar cdo dite dhe nga cdo vend aq me teper kur ato mungojne e jane zhdukur, atje ku ato po ripertrihen e po zhvillohen, dhjetori le te jete ne traditen e tij, me sa me shume veprimtari, duke mbjellur drure, duke permiresuar pyje, etj. Ishte ky prologu i nje bisede gjate nje



udhetim ne Dumre te shoqeruar nga botuesi Ali Lleshi, bir i kesaj zone, sot me banim ne Tirane. Sapo e njoftuam Aliun se Ne, nje grup specialistesh pyjesh do te shkonim ne Dumre per te zhvilluar nje takim per pyjet komunal ne Grekan, ai shprehu kenaqesine per pjesemarrje ne kete takim. Ai la cdo pune dhe u vu ne krye te karvanit te makinave qe do udhtonim per ne Grekan. Nga Tirana ne Grekan, nuk na lejoj te ndalonim as per kafe, mengjesin do ta hanim ne Belsh. Me miqte e tij, Aliu ne ai na gostiti mire dhe shpejt, pasi nxitonim per te kapur oren e takimit. Ne biseden me Alian ai thote : - Per pyjet vecanarisht jam shume i ndjeshem, dua te mos i mungojne kesaj pllaje kaq te bukur, ketyre banoreve kaq puntore, Dumreja ka nje te

ardhme te mire me turizmin ekologjik, padyshim pyjet jane te domosdoshme e do i japin asaje vlere akoma me te medha. Pasqyrat ujore te liqeneve te Dumrese ne se arrijme ti qarkojme me pyje, do arrijme te kemi pllajat unike ne Ballkan me mjedise te paperseritshme. Nuk di sa do te arrije, nese biznesi do me eci sadopak, sigurisht do kontribuojne ne kete drejtim. Malli dhe dashuria per vendlindjen jane ne thellesi te shpirtit tim shton Aliu. Gjate rruges Aliu u ndal disa here, kur shihte femije e u dhuronte libera e fletore, te pergatitura ne shtypshkronjen e tij.

Kolona e makinave here pas here ndalonte, ata qe vinin per here te pare ne Dumre donin te shijonin bukurite natyrore, ku spikasin liqenet karakteristike te zones, fshatrat e ndertuar buze tyre. Ne ngjitje te kodres prej ku do zbrisnim per ne Deshiran u ndalem disi me gjate, kishte disa njerz qe na prisnin dhe donin te na takonin. Njeri prej tyre ishte i njohur prej nesh qe pra disa vitesh. Eshte Banush Kuqja, me nje sakice ne dorë na pershendet dhe na fton ne bisede, aty ne mes nje grumbulli pyjor te ripertrire ne keto vite. Banush Kuqja, njihet per historite e tij me pyjet; si nje i burgosur para viteve 90 per deme ne pyje, por pas viteve 90 si nje njeri



teper i dashur me kontribute te vecanta ne ruajten dhe mbjelljen e drureve pyjor. Ai ka mbjellur me qindra fidana pyjor duke krijuar nje pyll me plep prej rreth 40 ha. Banushi na foli me pasion per ripertitjen e zhvillimin e mire te pyjeve ne komunen Grekan. Ai ishte dhe i shqetesuar per disa probleme qe kane lindur me DSHP, per pastrimin e dhe mirembajtjen e pyjeve te komunes. Ai fillon te tregojë per të pranishmit si nisi dhe sa shpejt u bë ripertitje e ketyre pyjeve. Ketu ne Grekan rreth 9 ose 10 vite me pare na erdhi Haki Kola me disa specialiste te tjere tregon Banushi. Na folen ne per nje projekt dhe mbeshtetjen qe do na jepnin per ti rimkembur perseri pyjet e Grekanit. Kodrat ketu, lugina poshte ishin te gjitha te çveshura qe u prene nga vitet 1992 dhe gjithçka mori fund ne vitin 1997. U pikelluan shume ne si fshat- thote Banushi pasi pyjet me terper u prene nga te huajt qe nga Kuçova e Lushnja. Me gjithate diku aje tek bregu i liqenit,



une fillova te mbjelle disa fidana plepi, bera disa ricungime Pas disa takimesh ne komune dhe ne fshtara, filloj mbeshtetja e Projektit te Pyjeve. U planifikuan disa punime, por kryesorja per ne fshtaret u percaktua ndalimi i kullotjes dhe rrethimi i zones qe do ripertithej. Biseda do vazhdonte gjate, Banushi dhe bashkefshataret e tije donin te thoshin shume gjera per keto vite. Ndoshta me plote goje mund te themi bere nje “mrekullin e gjelber”, ne Grekan. Sot, vete fshati eshte zot i pyllit, nuk lejon asnje demtim apo prerje, cdo gje kerkohet te behet sipas projekteve te studjuara.. Nga biseda me Banushin tejkaluam ndjeshem orarin e takimit, ndoshta ketu u thane natyrshem disa nga ato ishin prashkuar ne programin e takimit, mire u bë.

Vazhduam udhëtimin per ne Dishiran, ku na priten kryetari komunes, specialiste te pyjeve te Elbasanit, Gramshit, Librazhdit, banore vendas, etj.

Natyrja ka ofruar kushte ekologjike, ne banoret vendas ofruan punen e perkujdesjen, me finacime modeste të Projektit shqiptar të pyjeve, jemi sot me brendesi te nje masivi prej rreth 800 ha dushkajsh qe jane ne gjendje mjaft te mire, tha shkurt nga kryetari i komunes Grekan, Qemal Rama. Ai vazhdoi- ju si specialiste i shihni, i vleresoni vete, ne kemi nevojte per ju, te na percaktoni nderhyrjet e nevojshme per keto pyje. Duam qe pyllin ta kemi te perjeshtme dhe te marrim lende druri pa sjell demtim te tije. Ne duam te vine e te pushojme ne keto hije, te thithim ajrin e paster, jo vetem ne vendasit por dhe miqte qe duan te vizitojne Grekanin e Dumrenë.

Tashme qe keto pyje u ripertitren, kodrat u veshen, dushkajat fuqishem po zhvilloheshin cdo vit lindi si domosdoshmeri trajtimi dhe orientimi i tyre per te ardhmen. Sigurisht qe sivikultoret duhet te thone falen e tyre. Pikerisht per vleresuar ne terren disa trajtime eksperimentale te kryera ne disa siperfaqe prove, ishte dhe takimi ne dushkajat e Grekanit ne kuadrin e nje projekti te SNV dhe SIDA-as. Ne kater siperfaqe prove, sipas nje metodike te pergatitur nga ing Haki Kola e ing. Janaq Male, jane zbatuar kater tipe te ndryshme rrallimi. Rezultatet e eksperimenteve te arritura u prezantuan nga ing Isuf Salla, realizues i dhe ndjekes i punimeve. Diskutimet ne terren vazhduan gjate, argumenta dhe vleresime te ndryshme per cdo variant u dhane nga specialistet e pranishem, disa me pervoje te gjate ne pyje, dikush pedagog ne Fakultetin e Shkencave pyjore, dikush si pylltar komunal, etj. Ne perfundim mbeshtetur ne rezultatet e dukshme ne argumenta shkencor, duhej te zgjidhej dhe skema me e mire e nderhyrjes. Nga te pranishmit u vleresua maksimalisht ky takim larg akademizamave e prezantimeve steriotipe ne salla luksoze. Aty ku pylli po rritej dhe zhvillohej, po parashkruhej dhe e ardhmja e nje pylli per tu mbareshtuar sa me mire ne plotesimit te kerkesave mjedisore e turistike, ne plotesim te nevojave per lende druri. Tere keto diskutime ne nje pejsazh kaq te kendshem, nxitonte per ti filmuar gazetari aposionuar i bujqesises shqiptare Faut Memeli. Nuk do e kisha besuar thote Fuati se;- kaq shpejt dhe kaq

bukur mund te ripertrihej nje pyll si ky ne Grekan. Keto pyll, njerezit qe kanë kontribuar, ata qe sot e ruajne, duhet te jene objekt i mediave vizive dhe te shkruara. Fuati duke e vene theksin tek mediatizimi jo i plote i ketyre shembujve, shton se kam degjuar se dhe ne disa zona te tjera ne Elbasan si dhe ne rrethet Has, Mat, etj, ka pyje te ripertrire dhe fshtaret tregojne per to nje kujdes te jashtezakonshem, duke ndaluar cdo demtim. Duhet kerkuar dhe gjetur mundesi per ti mediatizuar keto modele dhe njerezit qe qendrojne pas tyre, pyjet nuk duhet te mbeten objekt i mediave vetem vetem ne dhjetor. Nuk duhet te perbejne lajm vetem mbjelljet e disa qindra fidanave akacie apo pishe, pasi nje rast si ky i Grekanit me dushkaja, jane vlera ne investime te cilat nuk arrihet as ne 30 vite. Bisedat, diskutimet dhe vleresimet e eksperimenteve te zbatuara ne Grekan, ne tresi per pyjet e Dumrese, i nderpreu muzgu i cili dalangadale po mbulonte pllajen e Dumrese.



Kjo dite e kenaqeshme ne pyjet e rilindura te Dumrese, nuk mund te mbyllej pa provuar dhe mikpritjen, gatimin tradicional pse jo dhe kengen e Dumrese. Le te kontribuojme per sa me shume pyje dhe zona te tjera. Dumreja e bekuar nga zoti le te behet akoma me e bukur dhe me e begate me pyjet e saje.